



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Tiranë më 03.02.2025

Nr. 725 prot.

**NJOFTIM**

**Për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator**

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se është përgatitur projektvendimi si vijon:


1. Projektvendim "Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe relacionit shoqërues.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**





Tiranë më

Nr.

**RELACION  
PËR  
PROJEKTVENDIMIN  
PËR  
MIRATIMIN E KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË  
FUQI**

Neni 20, pika 1, shkronja “g”, dhe 3 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor.

Neni 98, pika 1 ka parashikuar kompetencën e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit.

Neni 97, pika 1 parashikon se për zgjedhjet për Kuvend, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore.

Neni 25/1 pika 2 parashikon që fleta e votimit për zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit është e njëjtë, por me një element të veçantë dallues me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, Drejtoria e Ligjshmërisë ka hartuar projektvendimin “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Projektvendimi “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, ka për qëllim të përcaktojë karakteristikat teknike të fletës së votimit që do të përdoret për zgjedhjet Kuvend të datës 11 maj 2025.

Neni 97, pika 1 parashikon se për zgjedhjet për Kuvend, zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore.

Referuar nenit 98 të Kodit Zgjedhor, fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë.

Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elementë teknikë në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si dhe elementë të tjerë identifikues që nuk lexohen me sy të lirë (QR code). Elementët e sigurisë dhe elementët teknikë janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr. 1 që i bashkëlidhen projektvendimit dhe që është pjesë integrale të tij.

Komisioni Rregullator nuk mund të shprehet në mënyrë shteruese për dimensionet e fletëve të votimit, e për këtë arsye propozohet që me këtë vendim të miratohen dimensionet minimale të tyre. Në tekstin e projektvendimit është përcaktuar se përmasat e fletës së votimit mund të ndryshohen, në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen në zgjedhje brenda afatit ligjor.

Duke qenë se tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar për karakteristikat teknike të fletëve të votimit të përdorura për zgjedhjet pararendëse të vitit 2021 dhe 2023, propozohen specifikimet në lidhjet nr. 1, të cilat janë të njëjta me ato të përdorura në zgjedhjet e mëparshme.

Referuar këtyre eksperiencave përsa i përket specifikimeve teknike të fletëve të votimit, do të përdoren të njëjtat specifikime që janë përdorur në zgjedhjet pararendëse të cilat kanë rezultuar mjaft efikase dhe nuk ka pasur ndonjëherë kontestime. Konkretisht letra që do të përdoret për prodhimin e fletëve të votimit do të jetë e tipit letër e thurur (watermark) me dy shtresa, e cila në trupin e letrës ka fibra karboni të cilat shikohen shikohen me sy të lirë apo me rreze ultraviolet si dhe lejon printimin e elementeve shtesë të sigurisë. Dendësia e saj do të jetë jo më e vogël se 90 g/m<sup>2</sup> e cila është një letër më e trashë se ajo e përdorimit të zakonshëm dhe nuk lejon leximin e votës në pjesën e pasme të saj.

Risia e këtyre zgjedhjeve është votimi i zgjedhësve jashtë territorit të RSH. Fleta e votimit që do të përdoret nga këta zgjedhës është e njëjtë me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por me një shenjë dalluese ashtu si parashikohet në nenin 25/1 pika 2. Shenja dalluese e parashikuar në këtë rast është akronimi VJ (votues nga jashtë) që printohet përbri Fletë Votimi, siç citohet në lidhjen 1.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.”

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**


Kopje: 3

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

P.Doçaj

M.Çelmeta





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR**

Data:

Nr:

Ora:

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1 shkronja “g” dhe 3, nenit 25/1 pika 2, nenit 97 pika 1 dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përmasat e fletës së votimit përcaktohen në varësi të numrit të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO** Kryetar

**Arens ÇELA** Anëtar

**Dritan ÇAKA** Anëtar

**Helga VUKAJ** Anëtar

**Muharrem ÇAKAJ** Anëtar

Data: Nr:  
Ora:



“Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR**

**Lidhja 1**

**Disa karakteristika të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025**

**Lloji i letrës:**

Letër methurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m<sup>2</sup> 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

**Dimensionet e fletës së votimit:**

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 420 mm

**Specifikime të përgjithshme:**

Stema e Republikës

Logo KQZ, me ngjyra

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës (CMYK):

( C0%, M 11%, Y 36% K 0%)

**Qr kodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):**

- Qarku 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

**Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit**

Qarku

Qendra e votimit

**Elementë të veçantë dallues në fletën e votimit për votuesit jashtë territorit të RSH:**

Shenja: VJ (përbri Fletë Votimi)

Data: Nr:  
Ora:



“Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”